



Në mbështetje të nenit 11.2 , 11.2/a 11.2/b, 11.2/c 11.2/d,11.2/f dhe 11.2/g, nenin 64.2 pika (a) dhe (b), nenin 128.2 të Ligjin Nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.03/L-256 dhe Ligjit Nr.08/L-122 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/l 058 dhe ligjin nr. 04/l-122 si dhe ligjit nr. 03/l-073 për zgjedhje të përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 03/L-256 (më tutje Ligji) si dhe vendimit nr. 01/1229-2022 të datës 19.10.2022 të Kryesuesit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpallë:

K O N K U R S

1. KQZ - 04 / 2022 Drejtor i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike

Grada/Koeficienti:	Niveli i Lartë Drejtues- NLD – G1 / K- 25
Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë:	Kryesuesi i KQZ-së
Kohëzgjatja e emërimit:	4 vjet me mundësi vazhdimi të një mandati tjetër
Vendndodhja :	Prishtinë

Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Përgjegjës për administrimin dhe menaxhimin e përgjithshëm të zyrës.
2. Siguron që funksionet e zyrës të zbatohen në përputhje me akte ligjore, nënligjore në fuqi dhe vendimet e KQZ-së;
3. Përgatit raporte dhe rekomandime për Kryesuesin e KQZ-së dhe KQZ-në;
4. Koordinon aktivitetet me Sekretariatit e KQZ - së dhe PZAP-in;
5. Mbikëqyr proceset e regjistrimit të partive politike, certifikimit dhe kontrollit financiar të subjekteve politike;
6. Mbikëqyrë, hartimin e akteve nënligjore që kanë të bëjnë me Zyrën dhe bën planin për aktivitetet e punës së Zyrës;
7. Këshillon dhe udhëzon subjektet politike lidhur me obligimet ligjore ndaj KQZ-së;
8. Përfaqëson Zyrën brenda dhe jashtë institucionit;
9. Menaxhon punët dhe stafin e Zyrës;
10. Detyra dhe përgjegjësi të tjera që i caktohen nga Kryesuesi i KQZ-së;

Kriteret dhe shkathtësitë e përgjithshme për pranim:

1. Të jetë qytetar i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë diplomë të vlefshme universitare;
3. Të ketë së paku tetë (8) vjet përvojë profesionale, nga të cilat pesë (5) vjet në pozita udhëheqëse;
4. Të ketë një reputacion profesional dhe integritet moral;
5. Të mos jetë dënuar për veprë penale me vendim të formës së prerë nga gjykata;
6. Të mos ketë qenë anëtar i një subjekti politik, nuk i ka dhuruar kontribut një subjekti politik dhe nuk ka qenë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në ndonjë marrëdhënie kontraktuale me një subjekt politik pesë (5) vjet para paraqitjes së aplikimit të tij/saj;
7. Njohuri mbi procesin zgjedhor (e dëshirueshme),
8. Përvojë në zhvillimin organizativ, planifikim dhe menaxhimin e procesit të punës, menaxhim të burimeve njerëzore si dhe njohuri për përdorimin e teknologjisë informative,
9. Shkathtësi të shkëlqyeshme për hartim dhe shprehje me shkrim;
10. Aftësi dhe gatishmëri për të punuar me njerëz të përkatësive të ndryshme kulturore dhe etnike;
11. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare (e dëshirueshme);
12. Njohje e gjuhës angleze (e dëshirueshme);
13. Njohje të teknologjisë informative (MS Word, MS Excel dhe MS Access),

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara;
2. Kopjen e letërnjoftimit apo pasaportës;
3. Kopjen e diplomave mbi kualifikimin arsimor, për rastet e diplomave nga shtetet tjera, diplomat duhet të jenë të nostrifikuara;
4. Dëshmitë e punës të lëshuara nga institucionet ku ka punuar;
5. Certifikatë jo më e vjetër se tridhjetë (30) ditë nga dita e shpalljes së konkursit e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk ka dënim të shqiptuar për ndonjë veprë penale;
6. Deklaratën nën betim të paraqitur të nënshkruar nga kandidati;
7. Biografinë (cv) ;
8. Letrën motivuese, dhe
9. Deri në tre rekomandime nga punëdhënësit e kaluar.

Mënyra e aplikimit:

Aplikacioni dhe deklarata nën betim merren dhe dorëzohen në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Personelit, dhoma nr. 21, kati I-rë, Ish Ndërtesa e Bankës së Lubjanës,, Rruga “Migjeni” 10000 Prishtinë. Aplikacioni se bashku me deklaratën nën betim, mundë të merren në ueb faqen e KQZ-së, tek mundësi punësimi. Aplikacionet mundë të dorëzohen edhe në formë elektronike të skanuara, në adresën elektronike: zyra.personeli@kqz-ks.org. Për informata të hollësishme mund të kontaktoni në numrin e tel: 038-200-23-557 prej

orës 08:00 – 16:00, ose vizitoni ueb faqen e KQZ-së, në linkun: www.kqz-ks.org. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 4 ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës për të cilin konkurroni.

Kandidatët të cilët aplikojnë për këtë pozitë do të njoftohen lidhur me procesin e përfshirjes në listën e ngushtë, me shkrim nga zyra e personelit. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

Publikimi i konkursit bëhet në ueb faqen e KQZ-së, në media, rrjetet sociale dhe i hapur do të jetë prej datës: 21 tetor 2022 deri me 7 nëntor 2022 në ora 16:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe inkurajon aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore si dhe pjesëtarët e të gjitha komuniteteve në Kosovë, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

Ky proces i rekrutimit do të monitorohet nga përfaqësuesit e Projektit të Ambasadës Britanike. Kandidatët njoftohen që emrat dhe rezultatet e kandidatëve do të publikohen në faqen e internetit të Projektit të Ambasadës Britanike.

Kur të aplikoni për këtë pozitë, do të konsiderohet se pëlqimi është dhënë për publikim përkatës. Për këtë proces të rekrutimit do të ftohen edhe OJQ-të dhe organizatat e tjera ndërkombëtare të interesuara.